



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Në pajtim me nenin 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës të Kosove, Ligjin nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Rregullore nr.01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, Rregulloren e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit nr.02/2016 dhe Rregulloren nr.02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionin e Avokatit të Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

**K O N K U R S
për plotësimin e vendit të lirë të punës**

Titulli i vendit të punës:	Vozitës
Numri i referencës:	1/2020
Grada/Koeficienti:	Niveli Administrativ – G10/ 6.5
Mbikëqyrësi:	Udhëheqës i divizionit për shërbime të përbashkëta
Kohëzgjatja e emërimit:	Me afat të caktuar (1 vjeçar)
Vendi:	Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

1. Ofron shërbime për Avokatin e Popullit, zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe menaxheret tjerë që kërkojnë transport zyrtar;
2. Kujdeset për mirëvajtjen e punëve në transport, kryen mirëmbajtjen, servisimin e rregullt të veturës zyrtare, regjistron veturën zyrtare dhe mban kartotekën e veturës zyrtare;
4. Mban evidencën e urdhëresave të punës për autoservise, dhe përgatitë pasqyrën e kilometrave të kaluara të veturës zyrtare brenda çdo muaji së bashku me evidencën e kërkesave për veturë zyrtare, shënon kilometrazhin ditore, shpenzimin e lëndëve djegëse etj;
6. Kryen pranimin e faturave për shërbimet e kryera në lëmin e transportit dhe i dorëzon për procedurë të mëtejme për pagesë;
7. Mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e përditshme të automjeteve siç është pastërtia, pajisjet e domosdoshme, kontrolli i vajit, ujit, baterisë, gomave etj;
8. Kryen riparime të vogla dhe siguron që automjeti të jetë në gjendje funksionale për punë;
9. Siguron që të gjitha veprimet të jenë në pajtim me rregullat dhe rregulloret në fuqi për rastet e përfshirjes në aksident trafiku, lajmërimin të dëmeve të ndryshme, vozitjen e personave zyrtarë të IAP etj;
10. Është përgjegjës për dëmet e shkaktuara në automjetet dhe gjobat e marra në trafik nga pakujdesia apo mospërshtatja kushteve të komunikacionit;
11. Kryen edhe detyra të tjera, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Përgatitje shkollore e mesme, drejtimet teknike ose në fusha të ngjashme;
- Patentë shofer të kategorisë „B“;

- Njohje të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe, ndërsa preferohet njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
 - Vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale, jo më i vjetër se 6 muaj.
-

Procedura e konkurimit

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit. Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen: www.ombudspersonkosovo.org.

Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me Konkurs personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Migjeni“, nr. 21, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org, si dhe me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga pjestarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 5 shkurt 2020, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët që kanë aplikuar, por nuk janë përzgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit. Dokumentet që nuk tërhiqen administrohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782.